



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 6 (827962)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 13 shkurt 2026



KORRIDORI 8 SHPALLET KORRIDOR SIGURIE I NATO-s Shqipëria në zemër të planeve strategjike të Aleancës

» faqe 3



TAKIM TREPALËSH NË SHKODËR: INTENSIFIKOHET BASHKËPUNIMI USHTARAK SHQIPËRI-KROACI-KOSOVË

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në qytetin e Shkodrës takim trepalësh në nivel të Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm, me pjesëmarrjen e gjenerallejtënant Tihomir Kundid, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Kroacisë, si dhe gjenerallejtënant Bashkim Jashari, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës...

faqe 4



14 SHKURT 1969 - KRIJIMI I BATALIONIT TË VËZHGIMIT AJROR DHE ZHVILLIMI I FORCËS AJRORE SHQIPTARE

Forcat Ajrore Shqiptare janë një nga tre armët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke luajtur një rol vendimtar në mbrojtjen e hapësirës ajrore dhe sigurinë e vendit. Forca Ajrore përbëhet nga: Komanda dhe Shtabi i FAJ; Baza Ajrore Farkë; Baza Ajrore Kuçovë; Qendra e Vëzhgimit Ajror; Shërbimi Meteorologjik Ushtarak; Kompania e Mbështetjes së FAJ Përpjekjet për krijimin e Armës së Aviacionit datojnë që në vitin 1914, kur qeveria shqiptare porosi tre avionë "Lohner Daimler"...

faqe 7



DREJTËSIA QË PO VIHET NË PROVË: RASTI I ISH-KRERËVE TË UÇK-SË DHE PESHA E NJË VENDIMI TË PADREJTË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Aktakuza e konfirmuar më 26 tetor 2020 dhe dërgimi i tyre në paraburgim në Hagë, më 5 nëntor të atij viti, shënoi një kthesë të rëndë në historinë politike dhe juridike të Kosovës. Katër figura kyçe të luftës dhe shtetndërtimit u përballën me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit...

faqe 8

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Urdhri Sovran i Maltës nënshkruan një memorandum bashkëpunimi me synim rritjen e gatishmërisë dhe forcimin e mekanizmave të reagimit ndaj emergjencave civile, si dhe përmirësimin e mbështetjes mjekësore në situata krize.

Marrëveshja parashikon një bashkëpunim të strukturuar në fushën e Emergjencave Civile, duke përfshirë ndërhyrje të përbashkëta në raste fatkeqësish natyrore apo situatash të tjera emergjente, mbështetje teknike, angazhimin e ekspertëve përkatës, si dhe zhvillimin e trajnimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve. Një tjetër shtyllë e rëndësishme e memorandumit është shkëmbimi i informacionit mbi praktikatat më të mira dhe koordinimi i veprimeve në fazën pas emergjencës.

Pas nënshkrimit të memorandumit, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, theksoi rëndësinë e këtij partneriteti strategjik, duke bërë të ditur se në këtë kuadër priti në një takim Josef D. Blotz, Hospitalierin e Madh të Urdhrit Sovran të Maltës.

“Memorandumi i bashkëpunimit i firmosur sot nga Shqipëria përfaqëson një mundësi të rëndësishme për forcimin e gatishmërisë dhe mekanizmave të reagimit ndaj emergjencave civile, si dhe për mbështetjen mjekësore”, – u shpreh ministri Vengu.

Sipas tij, marrëveshja përcakton ndërhyrje të përbashkëta në raste emergjencash, zhvillimin e trajnimeve dhe programeve të ndërtimit të kapaciteteve, shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira, si dhe ofrimin e mbështetjes mjekësore në nivel civil dhe ushtarak.

“Ky partneritet synon rritjen e kapaciteteve të përbashkëta dhe një reagim më efektiv, në shërbim të një të ardhmeje më të sigurt”, – nënvizoi ministri Vengu.

Në aspektin shëndetësor, memorandum i përfshin shkëmbimin e personelit mjekësor dhe teknik, organizimin e trajnimeve të përbashkëta për strukturat civile dhe ushtarake, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave shëndetësore në shkallë të gjerë, si dhe bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik.

Ky memorandum përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së vendit përballë sfidave të emergjencave civile dhe krizave shëndetësore.

Në ambientet e Shkollës së Trupës u përmbyll me sukses kursi “Investigimi i incidenteve të municionit dhe trajnimi për ruajtjen e përkohshme, nën drejtimin e specialistëve amerikanë të Komandës Amerikane në Evropë (USEUCOM).

Në këtë trajnim morën pjesë 19 specialistë të menaxhimit të municioneve nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe nga struktura të ndryshme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke dëshmuar nivelin e lartë të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave profesionale ndërmjet institucioneve partnere.

Gjatë zhvillimit të kursit, pjesëmarrësit përfituan njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi shkaqet e incidenteve me municione, procedurat standarde të raportimit, hapat e hetimit teknik, si dhe praktikatat e sigurta të magazinimit të përkohshëm të municioneve, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë. Trajnimi u fokusua në forcimin e kapaciteteve profesionale për parandalimin, analizimin dhe menaxhimin e incidenteve, me synim rritjen e sigurisë në të gjitha hallkat e administrimit të municioneve. Kjo iniciativë përbën një kontribut të rëndësishëm në rritjen e profesionalizmit dhe standardeve të sigurisë në Forcat e Armatosura, si dhe në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me partnerët strategjikë.



MM dhe Urdhri Sovran i Maltës nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për forcimin e reagimit ndaj emergjencave civile



Përfundon kursi “Investigimi i incidenteve të municionit dhe trajnimi për ruajtjen e përkohshme” në Shkollën e Trupës





KORRIDORI 8 SHPALLET KORRIDOR SIGURIE I NATO-s Shqipëria në zemër të planeve strategjike të Aleancës

Ministrat e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, u mbledhën në Bruksel në një ministerial të rëndësishëm, ku në fokus ishte përshtatja e planeve të Aleancës me realitetin e ri të sigurisë në Evropë dhe më gjerë. Takimi vjen në një kohë sfidash të shumta gjeopolitike, rritjeje të investimeve në mbrojtje dhe rishikimi të kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes kolektive.

Në këtë ministerial mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, Pirro Vengu, i cili bëri të ditur një zhvillim me rëndësi strategjike për vendin: përfshirjen zyrtare të Korridorit 8 në planet dhe infrastrukturën kritike ushtarake të Aleancës.

Korridori 8, tashmë korridor sigurie i Aleancës

Sipas ministrit Vengu, Korridori 8 me pikënisje në kompleksin portual Durrës-Porto Romano dhe dalje në Detin e Zi është njohur si korridor sigurie për mbrojtjen kolektive. Ky vendim e vendos Shqipërinë në një pozicion kyç në arkitekturën euroatlantike të sigurisë, duke e kthyer vendin në një nyje strategjike të transportit, logjistikës dhe lëvizjes së forcave në rast nevojë.

“Kjo është një arritje konkrete, që e pozicionon Shqipërinë në zemrën e të gjitha planeve rajonale dhe në zemrën e infrastrukturave, ku Aleanca do të përqendrohet në vitet në vijim”, - theksoi Vengu, duke e cilësuar procesin si rezultat të një pune të disiplinuar dhe të qëndrueshme disa vjeçare.

Edhe kryeministri Edi Rama reagoi lidhur me këtë zhvillim, duke theksuar se njohja e Korridorit 8 si korridor sigurie “forcon ndjeshëm sigurinë rajonale” dhe rrit rolin e Shqipërisë në strukturat e Aleancës.

Rritja e rolit të Shqipërisë në misionin KFOR

Në fokus të diskutimeve ishte edhe e ardhmja e operacioneve ku Shqipëria kontribuon, veçanërisht misioni i KFOR-it në Kosovë. Ministri Vengu bëri të ditur se Shqipëria do të rrisë kapacitetet dhe përfshirjen e saj në këtë mision, duke u angazhuar për herë të parë edhe me Forcën Ajrore.

Ky hap konsiderohet një rritje cilësore e kontributit shqiptar në sigurinë rajonale, në një moment kur stabiliteti në Kosovë dhe në rajon mbetet prioritet për Aleancën. Sipas ministrit, në partneritet të ngushtë me Shtetet e Bashkuara dhe Komandën Amerikane në Evropë po bëhen rivlerësime të nevojshme për të ardhmen e misionit, duke krijuar gjithashtu një mundësi për qeverinë e re në Kosovë që të thellojë bashkëpunimin me NATO-n.

Investimet në mbrojtje dhe industria ushtarake

Një tjetër temë qendrore e ministerialit ishte rritja e investimeve në mbrojtje dhe rristurimi i industrisë ushtarake në vendet aleate. Në kushtet e një mjedisi sigurie gjithnjë e më kompleks, vendet



anëtare po rishikojnë strategjitë e tyre për prodhimin dhe furnizimin me pajisje ushtarake, me synim rritjen e kapaciteteve dhe autonomisë strategjike.

Ministri Vengu theksoi se Shqipëria e ka nisur me vendosmëri këtë proces, duke krijuar kapacitete të reja në industrinë e mbrojtjes, me disa kontrata të lidhura dhe të tjera në proces negociimi. Sipas tij, këto zhvillime janë mirëpritur nga aleatët, si pjesë e përpjekjeve për të forcuar kontributin e çdo vendi në kuadër të mbrojtjes kolektive.

Përgatitjet për Samitin e NATO-s në Tiranë 2027

Në kuadër të angazhimeve të ardhshme, ministri bëri të ditur se kanë nisur përgatitjet për Samitin e NATO-s, që do të mbahet në Tiranë në vitin 2027. Skuadrat shqiptare, në bashkëpunim me kolegët turq dhe Sekretariatit e Aleancës në Bruksel, kanë filluar punën për organizimin e këtij eventi të rëndësishëm

diplomatik dhe strategjik.

Mbajtja e Samitit në Tiranë pritet të jetë një moment historik për Shqipërinë, duke reflektuar rolin në rritje të vendit brenda NATO-s dhe besimin e Aleancës në kontributin shqiptar për sigurinë euroatlantike.

Një pozicionim i ri strategjik për Shqipërinë

Përfshirja e Korridorit 8 në infrastrukturën kritike të NATO-s, rritja e kontributit në KFOR, zhvillimi i industrisë ushtarake dhe organizimi i Samitit të vitit 2027 përbëjnë një paketë zhvillimesh që e vendosin Shqipërinë në një fazë të re të angazhimit të saj në Aleancë.

Ministeriali i Brukselit konfirmoi se në një mjedis të ri sigurie, ku sfidat janë të shumfshista dhe të ndërthurura, roli i vendeve anëtare përfshirë Shqipërinë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes kolektive.

Takim trepalësh në Shkodër: Intensifikohet bashkëpunimi ushtarak Shqipëri–Kroaci–Kosovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në qytetin e Shkodrës takimin trepalësh në nivel të Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm, me pjesëmarrjen e gjenerallejtënant Tihomir Kundid, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Kroacisë, si dhe gjenerallejtënant Bashkim Jashari, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe adresimit të sfidave të reja të sigurisë, në një mjedis strategjik gjithnjë e më kompleks. Bashkëpunimi ushtarak ndërmjet tre vendeve konsiderohet i konsoliduar dhe përfshin fusha si stërvitjet, trajnimet, operacionet dhe pjesëmarrjen në iniciativa rajonale.

Në fokus të diskutimeve ishte nevoja për intensifikimin e këtij bashkëpunimi përballë kërcënimeve hibride në rritje dhe rreziqeve të tjera që mund të cenojnë stabilitetin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, u theksua domosdoshmëria e gjenerimit dhe shfrytëzimit të sinergjive ndërmjet forcave të armatosura të tre vendeve.

Qëllimi i takimit trepalësh ishte identifikimi i fushave konkrete të bashkëpunimit që përmirësojnë ndërveprueshmërinë dhe gatishmërinë operacionale. Pjesë e diskutimeve ishte edhe vendosja e mekanizmave praktikë për koordinim dhe zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit operacional.

Një tjetër prioritet i rëndësishëm ishte zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në përputhje me Konceptin Strategjik të NATO-s, angazhimet që rrjedhin nga Samiti i Hagës 2025 dhe Busulla Strategjike e Bashkimit Evropian. Kjo nënkupton implementimin e planeve dhe projekteve që përforcojnë aftësitë operacionale dhe përgatitjen për misione të përbashkëta në kuadër të Aleancës dhe iniciativave evropiane të sigurisë.

Në përfundim të takimit, Shefat e Shtabeve të



Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Kroacisë, si dhe Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, ranë dakord për vijimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin

e stërvitjeve trelaterale konkrete gjatë vitit 2026 dhe në vijimësi, si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të sigurisë dhe stabilitetit në rajon.



Kompania e Urave, pjesë e Batalionit të Xhenios, ka nisur ndërhyrjen për ndërtimin e një ure metalike tip “Bailey” në territorin e Bashkisë Selenicë, në mbështetje të komunitetit lokal.

Ura me gjatësi 18 metra, seksion 2/1, do t’u shërbejë banorëve të fshatrave Bashaj, Matogjin, Vermik dhe Verbas, duke përmirësuar ndjeshëm qarkullimin dhe duke garantuar akses më të sigurt drejt shërbimeve bazë, institucioneve arsimore, shëndetësore dhe tregjeve lokale.

Ndërhyrja e Batalionit të Xhenios vjen në kuadër të angazhimit të Forcave të Armatosura për t’u ardhur në ndihmë komuniteteve, veçanërisht në zonat ku infrastruktura është dëmtuar ose paraqet vështirësi për lëvizjen e mjeteve dhe këmbësorëve.

Ndërtimi i urës tip “Bailey”, e njohur për fleksibilitetin dhe efikasitetin në montim, përbën një zgjidhje të shpejtë dhe funksionale, duke rikthyer lidhjen ndërmjet zonave të prekura dhe duke përmirësuar jetën e përditshme të banorëve.

Forcat e Armatosura vijnë në dëshmojnë profesionalizëm dhe gatishmëri jo vetëm në përmbushjen e misioneve ushtarake, por edhe në mbështetje të zhvillimit dhe sigurisë së komuniteteve në të gjithë vendin.

Kompania e Urave ndërton urë tip “Bailey” në Bashkinë Selenicë



Drejtësia që po vihet në provë: Rasti i ish-krerëve të UÇK-së dhe pesha e një vendimi të padrejtë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Aktakuza e konfirmuar më 26 tetor 2020 dhe dërgimi i tyre në paraburgim në Hagë, më 5 nëntor të atij viti, shënoi një kthesë të rëndë në historinë politike dhe juridike të Kosovës. Katër figura kyçe të luftës dhe shtetndërtimit u përballën me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, akuza të rënda, që prekin thelbin e moralit njerëzor dhe kujtesës kolektive të një populli.

Por sot, më shumë se kurrë, lind një pyetje thelbësore: *A po vihet në vend drejtësia, apo po ndërtohet një narrativë e padrejtë që rrezikon të deformojë historinë e luftës çlirimtare të Kosovës?*

Lufta për liri dhe pesha e historisë

UÇK-ja lindi në një kontekst të qartë represioni sistematik, spastrimi etnik dhe dhune shtetërore ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Lufta e viteve 1998–1999 nuk ishte një konflikt klasik për pushtet; ishte një përballje për mbijetesë dhe dinjitet kombëtar.

Të barazosh këtë luftë me narrativet e krimeve sistematike, pa e vendosur në kontekstin e një represioni të dokumentuar ndërkombëtarisht, është jo vetëm reduktim historik, por edhe padrejtësi morale.

Askush nuk është mbi ligjin. Ky është parim themelor i çdo shoqërie demokratike. Por po aq themelor është parimi se drejtësia duhet të jetë e barabartë, e paanshme dhe e çliruar nga ndikimet politike. Në rastin e ish-krerëve të UÇK-së, perceptimi i gjerë në opinionin publik shqiptar është se peshorja e drejtësisë nuk po qëndron në ekuilibër.

Dhomat e Specializuara, drejtësi e domosdoshme apo kompromis politik?

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar u themeluan në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës, nën presion të fortë ndërkombëtar. Ato janë formalisht pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë në Holandë, me personel ndërkombëtar.

Ky konstrukt juridik i pazakontë ka ngritur që në fillim pikëpyetje serioze:

- Pse një gjykatë për Kosovën funksionon jashtë territorit të saj?
- Pse trajton vetë pretendimet për krime të supozuara nga pjesëtarë të UÇK-së?
- A krijon kjo perceptimin e një drejtësie selektive?

Drejtësia selektive nuk është drejtësi. Ajo është kompromis politik i veshur me petkun e ligjit.

Nëse krimet e luftës janë universale dhe duhet të hetohen pa dallim, atëherë çdo narrativë që fokusohet vetëm në njërin palë, duke lënë në hije krimet e dokumentuara të aparatit shtetëror serb, krijon një boshllëk të madh moral dhe juridik.

Prezumimi i pafajësisë dhe procesi i gjatë

Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë deklaruar të pafajshëm. Sipas parimit themelor të drejtësisë, ata janë të pafajshëm derisa të provohet e kundërta.

Megjithatë, procesi i gjatë, paraburgimi i zgjatur dhe ekspozimi i vazhdueshëm publik kanë prodhuar një dënim të heshtur para vendimit përfundimtar. Në

Në historinë e kombeve ka momente kur drejtësia dhe politika përplasen në mënyrë të tillë sa kufiri mes tyre bëhet i mjegullt. Rasti i ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, përbën pikërisht një nga këto momente delikate për Kosovën dhe për vetë ndërgjegjen ndërkombëtare.



opinionin publik ndërkombëtar, vetë fakti i akuzës shpesh perceptohet si provë e fajësisë.

Kjo është një sfidë serioze për integritetin e procesit. Drejtësia nuk duhet të jetë spektakël. Ajo duhet të jetë e ftohtë, e matur dhe e bazuar vetëm në prova të pakontestueshme.

Rreziku i rishkrimit të historisë

Një nga shqetësimet më të mëdha që ngrihet sot në Kosovë është frika se përmes këtij procesi po rishkruhet historia e luftës çlirimtare.

Lufta e UÇK-së ishte përgjigje ndaj një regjimi që tashmë ishte dënuar ndërkombëtarisht për krime të rënda. Ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 ishte konfirmim i faktit se situata në Kosovë kishte kaluar çdo kufi humanitar.

Në këtë kontekst, të trajtosh luftën çlirimtare si një ndërmarrje kriminale kolektive do të ishte një shtrembërim historik me pasoja të thella për brezat e ardhshëm.

Askush nuk pretendon se në luftë nuk mund të ketë pasur shkelje individuale. Lufta është kaos. Por përgjegjësia individuale nuk mund të shndërrohet në përgjegjësi kolektive dhe as të përdoret për të njollosur një lëvizje të tërë çlirimtare.

Dimensioni politik i çështjes

Nuk mund të injorohet fakti se të akuzuarit janë figura që udhëhoqën jo vetëm luftën, por edhe procesin e shpalljes së pavarësisë dhe ndërtimit të institucioneve të Kosovës.

Në këtë aspekt, procesi gjyqësor ka një dimension të pashmangshëm politik. Çdo vendim do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin e brendshëm të Kosovës dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Nëse drejtësia perceptohet si e njëanshme, ajo rrezikon të prodhojë mosbesim afatgjatë ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe vetë konceptit të drejtësisë tranzicionale.

Drejtësia nuk duhet të jetë hakmarrje

Që drejtësia të jetë e vërtetë, ajo duhet të jetë e ndarë nga çdo formë hakmarrjeje politike apo presioni diplomatik. Ajo duhet të bazohet vetëm në prova të qarta, në standarde të larta procedurale dhe në respektim të plotë të të drejtave të të akuzuarve.

Çdo vendim që nuk i përmbush këto standarde do të mbetet i diskutueshëm në ndërgjegjen e popullit.

Kosova ka sakrifikuar shumë për të ndërtuar një shtet të bazuar në sundimin e ligjit. Por sundimi i ligjit nuk nënkupton nënshtrim ndaj padrejtësisë. Përkundrazi, ai kërkon guxim për të kërkuar drejtësi të vërtetë pa standarde të dyfishta.

Çështja e ish-krerëve të UÇK-së nuk është vetëm një proces gjyqësor. Ajo është një provë për mënyrën se si historia e Kosovës do të trajtohet në arenën ndërkombëtare.

Nëse drejtësia do të jetë e drejtë, e balancuar dhe e bazuar në prova të pakundërshtueshme, atëherë ajo do të forcojë themelet e shtetit të Kosovës. Por nëse perceptohet si selektive apo e motivuar politikisht, do të lërë plagë të thella në ndërgjegjen kolektive.

Kosova nuk kërkon imunitet për askënd. Ajo kërkon barazi. Ajo kërkon që drejtësia të mos bëhet instrument i narrativave të padrejta.

Një thirrje për drejtësi të vërtetë

Në fund, historia do të gjykojë jo vetëm të akuzuarit, por edhe vetë procesin. Do të gjykojë nëse drejtësia ndërkombëtare arriti të mbetet mbi politikën, apo u bë pjesë e saj.

*Drejtësia duhet të jetë e plotë.
Drejtësia duhet të jetë e paanshme.
Drejtësia duhet të jetë e drejtë.*

Vetëm atëherë vendimi do të pranohet si i tillë – jo si një akt formal juridik, por si një akt i vërtetë i së drejtës.

Sepse kur drejtësia vihet në provë, në provë vihet edhe vetë e vërteta.

Shkrimi me Dorë në Epokën Digjitale: Trashëgimia që Rrezikohet

Shkrimi me dorë në epokën digjitale: Humbje apo evolucion?

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Teknologjia po zë gjithnjë e më shumë vend në jetën e përditshme dhe në procesin mësimor. Pajisjet digjitale, tabletët dhe kompjuterët po zëvendësojnë gradualisht lapsin dhe fletoren. Si pasojë, gjithnjë e më pak fëmijë praktikojnë shkrimin me dorë, dhe ekspertët ngrenë shqetësime për këtë fenomen që po prek të gjithë njerëzimin.

Roli historik i shkrimit me dorë

Shkrimi me dorë ka qenë gjithmonë një mjet themelor i transmetimit të dijes. Nga letrat e para të shkruara në pergamenë, tek librat e shtypur dhe shënimet personale, shkrimi i dorës ka ruajtur kulturën dhe historinë njerëzore.

Shkrimi i dorës është një element kyç i përcjelljes së dijes brez pas brezi.

Ndikimi i teknologjisë dhe pajisjeve digjitale

Përdorimi i tabletëve dhe kompjuterëve: Fëmijët dhe të rinjtë kalojnë shumë kohë duke shkruar në ekran, gjë që zvogëlon kontaktin fizik me lapsin dhe fletoren. Si rezultat, aftësitë motorike fine që zhvillohen përmes shkrimit me dorë nuk ushtrohen.

Në një kohë kur ekrani po zëvendëson lapsin dhe fletoren, shkrimi i dorës mbetet një mjet i pazëvendësueshëm për zhvillimin e mendjes.


Perspektiva historike dhe krahasime ndërbreznore

Historikisht, shkrimi me dorë ka ndihmuar njerëzimin të transmetojë kulturën, historinë dhe dijen brez pas brezi. Librat, letrat dhe dokumentet ishin të gjitha produkte të shkrimit manual.

Krahasimet ndërbreznore:

- Brezat që rriteshin me laps dhe fletore kishin memorie më të zhvilluar vizuale;
- Brezat e sotëm që përdorin vetëm pajisje digjitale shpesh kanë shkrim më të ngadaltë dhe stil më uniform;
- Studimet tregojnë se shkrimi me dorë ndihmon në zhvillimin e gjuhës dhe të logjikës më shumë se shkrimi digjital;
- Në Japoni dhe Francë, shkollat po vendosin të ruajnë shkrimin me dorë si pjesë thelbësore të kurrikulës;
- Në Shtetet e Bashkuara, disa shtete kanë

Historikisht, shkrimi me dorë ka ndihmuar njerëzimin të transmetojë kulturën, historinë dhe dijen brez pas brezi. Librat, letrat dhe dokumentet ishin të gjitha produkte të shkrimit manual.



raportuar rënie të aftësive të shkrimit manual tek nxënësit e shkollave fillore.

Roli i shkrimit me dorë në zhvillimin konjitiv dhe emocional

Shkrimi me dorë përmirëson koordinimin dorësy, aftësitë motorike fine dhe ndihmon në zhvillimin e kujtesës afatgjatë. Ai është gjithashtu i lidhur me aftësitë për të planifikuar dhe strukturuar mendimet.

Ndikimi emocional:

- Shkrimi i dorës ndihmon në shprehjen personale
- Përmirëson përqendrimin dhe vetë-disiplinën

- Shërben si një formë relaksimi dhe reflektimi emocional

Shkrimi manual nuk është vetëm mjet edukativ, por edhe rrugë për të zhvilluar personalitetin dhe kreativitetin.

Zhvillimin personal dhe mësimor dhe një element i pazëvendësueshëm i kulturës njerëzore. Ruajtja dhe promovimi i tij është detyrë e përbashkët për mësuesit, prindërit dhe shoqërinë në përgjithësi.

Shkrimi me dorë është më shumë se një aftësi; është një trashëgimi që duhet të ruhet për brezat e ardhshëm.

14 Shkurt 1969 – Krijimi i Batalionit të Vëzhgimit Ajror dhe zhvillimi i Forcës Ajrore Shqiptare

Forca Ajrore, krenaria e radhëve të Ushtrisë

Forcat Ajrore Shqiptare janë një nga tre armët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, duke luajtur një rol vendimtar në mbrojtjen e hapësirës ajrore dhe sigurinë e vendit. Forca Ajrore përbëhet nga:

- Komanda dhe Shtabi i FAj
- Baza Ajrore Farkë
- Baza Ajrore Kuçovë
- Qendra e Vëzhgimit Ajror
- Shërbimi Meteorologjik Ushtarak
- Kompania e Mbështetjes së FAj

Përpyekjet për krijimin e Armës së Aviacionit datojnë që në vitin 1914, kur qeveria shqiptare porosi tre avionë “Lohner Daimler” nga Austria për formimin e Korpusit Ajror. Për shkak të Luftës së Parë Botërore, urdhri u anulua dhe gjatë viteve 1920-1930 Shqipëria nuk kishte burimet e nevojshme për të zhvilluar një forcë ajrore.

“Hapi i parë ishte guxim dhe vizion – pavarësisht sfidave ekonomike, ideja për një Aviacion Ushtarak nuk u shua.”

Lindja e Aviacionit Luftarak Shqiptar

Pas Luftës së Dytë Botërore, krijimi i Aviacionit Luftarak u institucionalizua. Data zyrtare e krijimit është 24 prill 1951. Së bashku me aviacionin, u institucionalizua edhe Vëzhgimi i Hapësirës Ajrore. Më 14 shkurt 1947, u krijua kompania e VAIN-it për vrojtimin e hapësirës ajrore dhe informimin për objektet e zbuluara.

Grupimi i parë i avionëve luftarakë ndodhi në Tiranë në vitin 1951, me avionë PO-2 dhe JAK-18. Ndërsa Reparti i parë i Aviacionit Reaktiv u krijua në Kuçovë në 1955, me avionë MIG-15.

“Çdo avion ishte një hap drejt modernizimit dhe sigurimit të hapësirës ajrore të vendit”, shprehet një veteran i FAj-së.

Në vitin 1957, u krijua Reparti i Transportit Ushtarak në Tiranë me avionë Po-2, JAK-18 dhe helikopterë MI-1 dhe MI-4.

Përparimi i teknologjisë dhe strukturës

Në vitin 1962 u krijua Regjimenti i Aviacionit në Rinas, me një skuadrilje MIG-19 dhe një skuadrilje MIG-17, dhe Shkolla e Aviacionit për trajnimin e pilotëve.

Në vitin 1967, **Regjimenti i Helikopterëve** u pajis me mbi 30 helikopterë MI-4, ndërsa në vitin 1974 u krijua **Regjimenti i Gjadrit**, i pajisur me MIG-21 dhe MIG-19, përveç avionëve mësimorë MIG-17 dhe MIG-15.

Në vitet ’70, Aviacioni Luftarak kishte mbi 70 MIG-19, 12 MIG-21 dhe shumë MIG-17 e MIG-15 për trajnimin e pilotëve, si dhe katër avionë transporti IL-14 dhe 12 AN-2 për transport trupash dhe mbështetje ekonomike.

Batalioni i Vëzhgimit Ajror dhe roli i tij kyç

14 shkurti 1969 shënon krijimin e Batalionit të Vëzhgimit Ajror, një njësi kyçe për monitorimin e hapësirës ajrore të vendit. Ky batalion ishte pasues i strukturave të mëparshme dhe më vonë evolui në



Qendrën e Vëzhgimit Ajror, vend dislokimi i së cilës është sot në Rinas.

Batalioni siguroi një lidhje të ngushtë me Aviacionin Luftarak dhe Mbrojtjen Kundërajrore, duke garantuar bashkëpunim të pandërprerë mes njësive për monitorim dhe reagim.

“Vëzhgimi i hapësirës ajrore është syri dhe veshët e Forcës Ajrore”, thonë veteranët.

Mbrojtja Kundërajrore dhe koordinimi me Aviacionin

Mbrojtja Kundërajrore ka një histori të pasur që nis më **1 korrik 1931**, me vendosjen e tri baterive të para në portet e Shëngjinit, Durrësit e Sarandës.

Në vitet ’50-’60, njësi të armatosura me topa 57mm dhe 100mm, raketa të drejtuara dhe radarë të zbulimit, u pajisën për të garantuar mbrojtjen e vendit.

Regjimenti i Raketave të Drejtuara u krijua më **6 dhjetor 1968** dhe konsiderohej krenaria e armës.

Në bashkëpunim me Aviacionin dhe Vëzhgimin Ajror, këto njësi siguruan një mbulim të plotë të hapësirës ajrore shqiptare, duke integruar mjete të sofistikuara teknologjike dhe struktura komanduese.

Figurat kryesore dhe kontributi i tyre

Shumë komandantë dhe ushtarakë kanë shënuar historinë e Forcës Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore. Disa prej tyre janë:

- Komandantët e Aviacionit:** Edip Ohri, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj;

- Ushtarakë të njohur:** Rrahman Parllaku, Gjini Marku, Hito Çako, Todi Naço, Sotir Filto, Arif Hasko, Niko Hoxha, Babaçe Faiku, Haki Jupasi, Stefan Kagjini, Lulo Musai, Perikli Teta, Foto Lako, Harilla Rebi, Perlat Sula, gjeneral-brigade Astrit Jaupi;

- Komandantë të Artilerisë Kundërajrore:** Muharrem Shabani, Simo Dhamo, Atif Ruci, Raqi Iftica, Siri Strazimiri, Savo Kavaja, Kiço Janku, Naun Gjiniakasi, Maqo Zoto, Bejto Isufi, Pasho Zhupa, Qendro Mustafaraj, Alush Bisha, Namik Shehu, Ferhat Turhani, Pëllumb Gjondedaj, Metan Ismaili, Vangjel Mati, Xhevdet Ramçaj, Hiqmet Zyberi, Rustem Lami, Arqile Kokëdhima, Mehmet Mehmetaj, Tomorr Mukaj.

E ardhmja e Forcës Ajrore dhe Vëzhgimi Ajror

Pas viteve 2000, Forca Ajrore ka përmirësuar kapacitetin e saj me teknika fluturuese Perëndimore:

- 2001: Helikopterët AB-206
- 2003: Skuadrilja AB-206 e kompletuar
- 2004: Helikopteri AB-205
- 2007: Helikopteri për transport VIP A-109 dhe BO-105
- 2012-2015: Cougar dhe EC-145 shumëfunksionale

Struktura moderne e Forcës Ajrore integron koordinimin me Mbrojtjen Kundërajrore dhe Vëzhgimin Ajror, duke siguruar mbrojtjen e plotë të hapësirës ajrore dhe aftësi reagimi në kohë reale.

“Nga Batalioni i Vëzhgimit Ajror në 1969 deri tek teknologjia moderne e sotme, Forca Ajrore shqiptare ka evoluar për t’u bërë krah i fuqishëm dhe i besueshëm i mbrojtjes së vendit.”

Arkivi ushtarak shqiptar në pasqyrimin e dokumenteve historike



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Traditë e një arkivi për historinë ushtarake

Buletinit Arkivor Ushtarak, organ teoriko-arkivor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura e ka nisur rrugëtimin e tij në marsin e vitit 2011. Në këto vite të botimit të tij, ai hyri modest dhe i thjeshtë, duke pasqyruar ecurinë e arkivistikës shqiptare dhe të arkivit ushtarak si pjesë e rëndësishme e pasurisë kombëtare. Gjatë kësaj periudhe 15-vjeçare buletini ka pasqyruar në vijimësi historinë ushtarake dhe dokumente të rëndësishme që kanë të bëjnë me historinë ushtarake, veçanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vëmendje të veçantë në buletin i është kushtuar dokumenteve historike të përgatitura me kujdes nga kryetari i bordit, prof. asoc. dr. Teki Kurti, kryeredaktore msc. Alketa Gjolligaj, operatore Bleona Meço, Kostanca Duka, Rajmonda Hankollari, si dhe bashkëpunuan e ndihmuar Elisabeta Tane, Matilda Toçe, Mirvjena Imami e Valbona Zyberi.

Buletini i vitit 2025 përkoi dhe me 80-vjetorin e Europës, që bëri qëndresë ndaj tiranisë dhe pushtimit e ngriti armët kundër agresorëve nazifashistë. Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA), ka në administrim një fond të konsiderueshëm dokumentesh së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Në këtë arkiv gjendet fondi i Komandës Supreme Gjermane, i Komandave Ushtarake Gjermane në Ballkan, si dhe i përfaqësuesve të ambasadave gjermane në Tiranë, në Romë e në Beograd, me një volum prej mbi 55 mijë fletësh. Dokumentet na japin të dhëna mbi veprimtarinë ushtarake të forcave pushtuese në Shqipëri dhe në Ballkan, dokumentet pasqyrojnë dhe veprimtarinë e formacioneve të armatosura shqiptare për çlirim, si dhe aktivitetin politik e ushtarak të përfaqësuesve gjermanë në Shqipëri e në Ballkan. Pjesa më e madhe e dokumenteve, që flasin për Shqipërinë dhe shqiptarët, janë të përkthyer në gjuhën shqipe.

Siç dihet në arkiv ndodhet dhe fondi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në këtë fond të bollshëm gjenden dosje që përmbajnë thirrje, njoftime, shpallje të aleatëve anglo-amerikanë, drejtuar popullit shqiptar. Këto materiale botoheshin në gjuhën shqipe në Bari të Italisë, ku dhe gjendej Shtabi Aleat i Mesdheut. Ky shtab në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, drejtoi dhe bashkërendoi veprimet luftarake kundër pushtuesve gjermanë e aleatëve të tyre në zonën e Mesdheut. Shtabi komandohej nga gjenerali Sir Henry Maitland Wilson.

Pjesa më e madhe e thirrjeve drejtuar popullit shqiptar shpërndaheshin në Shqipëri, nëpërmjet ajrit nga forcat ajrore britanike dhe amerikane (RAF dhe USA AF). Aleatët nëpërmjet misioneve ushtarake në terren, njihnin gjendjen dhe situatën ushtarake e politike në Shqipëri. Materialet propagandistike të hedhur në territorin shqiptar, demaskonin maskën e pushtuesit për deklaratat e tyre për “Indipendencë” të rreme, gjoja të shpallur nga gjermanët. Aleatët iu bënë vazhdimisht thirrje shqiptarëve për t’u bashkuar rreth organizatave të rezistencës dhe të luftonin për drejtësi në krahë të Anglisë, Amerikës dhe të Rusisë gjer në fitoren përfundimtare.

Dokumentet gjermane flasin se gjatë viteve 1943-1944 pushtuesit nazistë u kishin shpërndarë mbi 10 000 pushkë Ballit Kombëtar dhe nacionalistëve të tjerë, për t’i përdorur kundër rezistencës antifashiste që zhvillohej në Shqipëri nga Ushtria Nacionalçlirimtare. Pushtuesit gjermanë dhe bashkëpunëtorët e tyre në Shqipërinë Veriore kishin filluar organizimet për të luftuar brigadat sulmuese që po kalonin në zonën veriore. Kështu ushtria hitleriane në Shqipëri, po thurte kurthe të kurditura



për të goditur rezistencën antifashiste të udhëhequr nga Ushtria Partizane Nacionalçlirimtare, ku në disa raste dhe funksionuan. Por rezistenca antifashiste e shqiptarëve e mbështetur dhe nga Aleatët, nuk u shua por ajo shkoi deri në fitore ndaj nazistëve gjermanë. Këto dokumente ndihmojnë studiuesit në analizën që që ndriçojnë të fshehtat e nazistëve gjermanë, kundrejt Luftës Antifashiste të shqiptarëve.

Dokumente anglo-amerikane të rezistencës antifashiste në Shqipëri në vitet 1943-1944

Buletini fillon me një apel të Kombeve të Bashkuara drejtuar popullit shqiptar, ku theksohet thirrja për të mos u mashtuar nga propaganda gjermane, por të qëndronin në luftë për liri përkrah aleatëve. Më tej zënë vend dokumente si: deklarata e Çurçillit dhe amerikanëve për ndëshkimin e fajtorëve të krimeve naziste, si kujtesë dhe paralajmërim për brezat e ardhshëm; kur Shqipëria u ndje e tradhtuar; thirrje e nacionalistëve kundër aleatëve; Abaz Kupi kërkon garanci për kufijtë e Shqipërisë, prill 1944; në vitin 1943, një raport i gjeneralit Davies mbi situatën në Shqipëri. Gjithashtu zënë vend në buletin dhe telegrami i gjeneralbrigadier Davies, i datës 17 dhjetor 1943, bashkë me një letër shoqëruese të Shtabit të Forcës 133, të cilat i drejtohen komandës së tyre. Aty theksohet se gjenerali Davies mbron pikëpamjen për ndërprerjen e marrëdhënieve të misioneve britanike me Ballin Kombëtar dhe Legalitetin, denoncimin e tyre publik përmes BBC dhe bërjen e një deklarate në favor të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Dokumente nga fondi “komanda gjermane” në vitet 1943-1944

Në këtë pjesë zënë vend disa materiale që theksojnë se qeveria shqiptare dhe nacionalistët, antikomunistët duke bashkëpunuar në politikë me Gjermaninë dhe me grupe në Shqipërinë e Veriut (1943), flasin për një strategji të pushtuesve gjermanë në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë dhe Ballin Kombëtar, kundër Frontit Nacionalçlirimtar shqiptar. Në këtë periudhë ushtria gjermane po armatoste dhe mobilizonte Frontin Nacional kundër Frontit Nacionalçlirimtar dhe aleatëve britanik. Dokumente të tjera që flasin për bashkëpunimin e Ballit Kombëtar me ushtrinë pushtuese gjermane në Shqipëri, kundër ushtrisë partizane, si dhe thirrje për luftë vëllavrasëse, ku dalin komunikimet gjermane dhe strukturat kolaboracioniste, në përpjekje për shtypjen e rezistencës antifashiste në

Jug të Shqipërisë. Në një dokument shkruhet se kriza politike në qeverinë shqiptare, ishte shfaqur që nga mobilizimi nga gjermanët i Këshillit të Regjencës, në lidhje të ngushtë të udhëheqësve nacionalistë të Veriut kundër Frontit Nacionalçlirimtar; përpjekjet e fundit të gjermanëve për të ruajtur kontrollin politik e ushtarak, i cili po ndryshonte me shpejtësi, si dhe një dokument ku flitet për nacionalizmin dhe kolaboracionizmin e Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit në strukturat politike të pushtimit gjerman 1943-1944.

Organizata politike shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore në vitet 1943-1944

Janë disa dokumente rresht që flasin mbi themelimin e Organizatës së Fshehtë “Bashkimi i shqiptarëve”; Lëvizja Kombëtare “Shqiponja”, thirrje e trakte lëshuar nga Organizata e “Legaliteti”, lajme me rëndësi, thirrje popullit shqiptar dhe gjithë partive politike shqiptare, Partia Nationale “Zogiste”, vendimi i Kongresit “21 Nanduer 1943”, si dhe njoftim i major Abaz Kupit drejtuar Kryesisë së Këshillit “Nacionalçlirimtar” dhe materiale e letra të tjera që bëjnë fjalë për këtë periudhë të luftës.

Dokumente të organizatave politike shqiptare dhe të institucioneve kuislingë

Buletini paraqet dhe mjaft dokumente të skanuara që bëjnë fjalë dhe trajtojnë lista emërore të funksioneve të Këshillit epror fashist, si dhe Delegacionin kuisling shqiptar që i ka dorëzuar kurorën Viktor Emanuelit, mbretit perandor të Italisë. Në buletin zënë vend dhe disa thirrje lëshuar nga Komiteti Ekzekutiv i Përkohëshëm në Tiranë; shpallje të ndryshme lëshuar nga Prefektura e Vlorës, urdhra të lëshuara nga Prefektura e Korçës, mbi organizimin e Komisionit shqiptar për lirinë e pavarësinë të Shqipërisë etnike, Statuti i Partisë Politike Kombëtare Social-Demokrate, mbi Shoqatën Anglo-Shqiptare, raport me rastin e kremtimit të 20-vjetorit të milicisë vullnetare, trakte lëshuar nga Prefektura Durrës, buletini i Partisë Nacional-Ballkanike Shqiptare “Beslidhja”, trakte lëshuar nga organizata “Roja e drejtësisë”. Buletini pasqyron dhe disa foto të formacioneve të Ushtrisë Antifashiste Partizane Vullnetare Nacionalçlirimtare shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Arritje të arkivit gjatë vitit 2025

Është krijuar një traditë ku drejtoria e arkivit në buletin bën dhe pasqyrimin e veprimtarisë gjatë vitit të mbështetur në aktet ligjore dhe në udhëzimet e ministrit të Mbrojtjes. Në një material të shkurtër flitet për shërbimin arkivor, për përgatitje aktesh, për financën dhe mbështetjen si dhe disa tregues kryesorë gjatë veprimtarisë në vitin 2025. Në fund janë disa foto që flasin për procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në AQFA. E shkuara historike nuk është thjesht një e shkruar, nuk është thjesht një ngjarje dhe një dokument, por kjo na ndihmon të shikojmë realisht të tashmen dhe na ndihmon për të shikuar të ardhmen, nëpërmjet këtyre dokumenteve. Analiza historike e dokumenteve na ndihmon të gjykojmë dhe të vendosim për njohuri dhe analiza më të plota për të ardhmen, pasi nuk duhet të bëhen gabimet e së kaluarës dhe të rrugëtimit me zigzage të forcës ushtarake të shtetit. Koha dixhitale e rrjeteve sociale na mundëson për një komunikim me përdoruesit, na jep një liri informacioni, qarkullim të lirë të ideve, por sjell dhe dyshime për cilësinë dhe vërtetësinë e përmbytjes të informacionit të shpërndarë.

Arkivi është qendra e kërkimit të së vërtetës dhe këtë shumë mirë po e loz dhe buletini, i cili tashmë ka nisur një rrugëtim, ku është burim i privilegjuar, duke qenë rojtar i rëndësishëm i kujtesës historike kolektive të një shoqërie të caktuar. Duke qenë se arkivi mbart kujtimet e një periudhe të caktuar historike të vendit, krijon dhe një mundësi për të komunikuar pozitivisht me studiuesit dhe me publikun, duke nxjerrë në pah cilësitë morale dhe njerëzore, disiplinën dhe përgatitjen, ndjenjën e fortë që ka karakterizuar pasionin për të bërë një forcë të armatosur për të ecur përpara. Sfidat që qëndrojnë sot për arkivin kërkojnë nxitjen e këtij proces, përdorimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, duke e kthyer në një qendër dhe burim të njohurive dhe të krijimtarisë së FA-së. Ky rrugëtim i Buletinit Arkivo-Ushtarak tashmë është i përcaktuar qartë dhe FA-të krenohen me një institucion të tillë.

Forcat e Armatosura, dhe në veçanti Forca Detare, humbën një nga figurat e tyre më të spikatura, me ndarjen nga jeta të Ing. Viktor Pashko, ushtarakut të përkushtuar, drejtuesit vizionar dhe njeriut me integritet të lartë moral.

Jeta dhe veprimtaria e tij profesionale ishin të lidhura ngushtë me detin dhe me zhvillimin e kapaciteteve të Forcës sonë Detare. Gjatë karrierës së tij të gjatë, ai mbajti me përgjegjësi të lartë disa nga detyrat më të rëndësishme drejtuese, si Komandant i Nëndetëses së 3-të, Komandant i Kantierit të Anijeve, Komandant i Brigadës së Nëndetëseve dhe Komandant i Flotiljes Detare (FLD). Në secilën prej këtyre funksioneve ai la gjurmë të dukshme profesionale, duke kontribuar në rritjen e gatishmërisë, disiplinës dhe standardeve tekniko-ushtarake të strukturave që drejtoi.

Ing. Viktor Pashko shquhej për profesionalizëm të lartë, kulturë të gjerë teknike dhe aftësi të spikatura organizative. Ai ishte drejtues kërkuar, por i drejtë; korrekt në zbatimin e rregulloreve dhe i palëkundur në mbrojtje të interesave të institucionit. Vendimarrja e tij mbështetej në analizë të thellë, përvojë praktike dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie. Për breza të tërë detarësh dhe specialistësh, ai mbeti model i oficerit profesionist dhe i komandantit që frymëzon me shembullin personal.

Përtej uniformës, ai ishte njeri me virtyte të rralla. Familjar i përkushtuar, shok dhe mik i çmuar, ai gëzonte respekt të veçantë për shkak të karakterit të fortë, edukatës fisnike dhe figurës së pastër morale. Komunikimi i tij i ngrohtë, thjeshtësia dhe gatishmëria për të mbështetur të tjerët krijuan rreth tij një rreth të gjerë miqsh e bashkëpunëtorësh që sot e kujtojnë me mirënjohje.

Ndarja e tij nga jeta përbën një humbje të ndjeshme për familjen, për komunitetin ushtarak dhe për të gjithë ata që patën privilegjin të punonin pranë tij. Kontributi i tij në Forcën Detare mbetet pjesë e historisë së saj institucionale, ndërsa kujtimi i tij do të ruhet me respekt në memorien e kolegëve dhe vartësve.

“Forca e një komandanti matet jo vetëm me detyrat që mban, por me gjurmën që lë në njerëzit që drejton.”

Ing. Viktor Pashko e la këtë gjurmë.

*Lamtumirë dhe lundrim të qetë në përjetësi.
I paharruar.*

LUNDRIM TË QETË, Ing. Viktor Pashko



IN MEMORIAM



Lamtumirë, Nënkolonel AGRON DIKO ZEQQO

Me dhimbje të thellë dhe nderim të veçantë, Forcat e Armatosura përcjellin Nënkolonel Agron Diko Zeqo, një prej ushtarakëve më të përkushtuar dhe më të respektuar të brezit të tij. Ndarja e tij nga jeta është një humbje e madhe për familjen, kolegët dhe për gjithë komunitetin ushtarak, ndërsa kujtimi i tij do të ruhet me respekt dhe mirënjohje.

Karriera e Nënkolonel Zeqos ishte e ndërtuar mbi profesionalizëm të lartë, disiplinë të paepur dhe devotshmëri ndaj detyrës. Ai shërbeu me përkushtim të plotë në strukturat ku u caktua, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve operative dhe përmirësimin e organizimit të trupave. Në çdo detyrë, Agron Zeqo tregoi aftësi të spikatura menaxheriale, vendimarrje të drejtë dhe qartësi strategjike, duke fituar respektin dhe besimin e vartësve dhe kolegëve.

Figura e tij profesionale shquhej për seriozitet, korrektësi dhe përgjegjësi të lartë. Ai ishte shembull i disiplinës dhe përkushtimit ndaj standardeve të Forcave të Armatosura, duke mbajtur gjithmonë një nivel të lartë profesionalizmi që frymëzonte të gjithë rreth tij. Për breza të tërë oficerësh dhe ushtarësh, Agron Zeqo mbeti një model i komandantit dhe bashkëpunëtorit të devotshëm.

Por Nënkolonel Zeqo ishte gjithashtu një njeri me virtyte të rralla. Familjar i përkushtuar, bashkëshort dhe prind i dashur, ai krijoi rreth vetes një atmosferë ngrohtësie dhe respekti. Shok dhe mik i çmuar, ai njihej për karakterin e fortë, edukatën fisnike dhe komunikimin e hapur, duke ndihmuar gjithmonë të tjerët dhe duke mbështetur kolegët në çdo situatë. Personaliteti i tij i bënte të gjithë të ndiheshin të respektuar dhe të vlerësuar, duke e bërë prani të pazëvendësueshme në çdo ekip.

Kontributi i Nënkolonel Agron Diko Zeqo në Forcat e Armatosura është i paharrueshëm. Ai la gjurmë të thella në zhvillimin dhe profesionalizimin e strukturave ku shërbeu dhe u bë shembull i vlerave të qëndrueshme për çdo brezi të ardhshëm ushtarakësh. Karakteri, integriteti dhe dashuria për detyrën e bënë emrin e tij të respektuar dhe të paharrueshëm.

Lamtumirë, Nënkolonel Agron Diko Zeqo!
I paharruar për kolegët, miqtë dhe Forcat e Armatosura.



11 SHKURTI 1920, Tirana kryeqyteti i Shqipërisë

Nga Kongresi i Lushnjës te vendosja e qeverisë në Tiranë

11 shkurti i vitit 1920 shënon një nga momentet më të rëndësishme në kalendarin historik të shtetit shqiptar. Në këtë datë, qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës u vendos në Tiranë, duke e shpallur atë kryeqytet të përkohshëm të Shqipërisë. Kjo ngjarje përbën fillesën e jetës së Tiranës si qendër politike, administrative dhe kombëtare e vendit.

Pas shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, Shqipëria kaloi nëpër një periudhë të vështirë trazirash politike, ndërhyrjesh të huaja dhe mungese stabiliteti institucional. Lufta e Parë Botërore dhe copëtimi i territoreve shqiptare nga fuqitë ndërluftuese e kishin dobësuar ndjeshëm shtetin e brishtë shqiptar. Në këtë kontekst kritik, Kongresi i Lushnjës (21–31 janar 1920) u mbledh si një akt i lartë kombëtar për të rivendosur sovranitetin e vendit dhe për të organizuar institucionet shtetërore mbi baza të reja.

Kongresi mori vendime themelore: rrëzoi qeverinë e Durrësit, formoi Këshillin e Lartë, Këshillin Kombëtar dhe një qeveri të re me kryeministër Sulejman bej Delvinën. Një nga vendimet më strategjike ishte shpallja e Tiranës si kryeqytet i përkohshëm i Shqipërisë, më 9 shkurt 1920, duke lënë të hapur çështjen e shpalljes përfundimtare nga një Asamble Kushtetuese.

Pas vitit 1920, Tirana nisi një transformim të thellë urban dhe institucional. Dokumentet e kohës dëshmojnë për hartimin e planeve rregulluese, ndërtimin e godinave qeveritare dhe organizimin e infrastrukturës urbane që do t'i rezistonte kohës. Një pjesë e këtyre të dhënave janë përmbledhur në një album të hartuar nga Osman Myderizi, i ruajtur në regjistrat e seksioneve të Bashkisë së Tiranës, duke përbërë një burim të vyer për historinë urbane të kryeqytetit.

Pse Tirana? Arsyet strategjike dhe administrative

Në atë kohë, Tirana kishte një popullsi të krahasueshme me Elbasanin, por ofronte kushte më të përshtatshme për vendosjen e organeve qeveritare. Qyteti dispononte më shumë ndërtesa të mëdha, lokale publike, rrugë të gjera dhe hotele, duke krijuar mundësi reale për sistemimin e administratës shtetërore.

Një rol të veçantë në përgatitjen e terrenit për këtë vendim luajti kleriku dhe atdhetari Ismail Ndroqi, Kryetar i Bashkisë së Tiranës në vitin 1920. Ai kontribuoi në organizimin dhe mbështetjen e Kongresit të Lushnjës, si dhe në sistemimin e institucioneve të reja shtetërore në kryeqytetin e ri. Administrata u sistemua me ndihmën e Bashkisë së Tiranës, duke treguar gatishmërinë e qytetit për të marrë mbi vete


përgjegjësinë historike.

11 Shkurti 1920, Hyrja solemne e qeverisë në Tiranë

Më 11 shkurt 1920, pasi repartet e ushtrisë italiane ishin larguar nga Tirana dhe ishin vendosur në Durrës, anëtarët e Këshillit të Lartë, qeveria dhe Këshilli Kombëtar hynë në qytet. Kjo hyrje u prit me entuziazëm të madh nga populli tiranas.

Në krye të qeverisë ishte Sulejman bej Delvina. Në godinën në fillim të rrugës së Elbasanit u vendos qeveria shqiptare, duke shënuar zyrtarisht fillimin e funksionimit të Tiranës si kryeqytet i vendit. Populli i Tiranës jo vetëm e mirëpriti qeverinë, por ishte i gatshëm ta mbronte atë me gjak, në një kohë kur rreziku ndaj sovranitetit kombëtar ishte ende i pranishëm.

Fotografia e hyrjes së organeve qeveritare shqiptare



GODINA E PARË E BASHKISË SË TIRANËS DERI NË VITIN 1930

në Tiranë përjetëson këtë moment historik. Në të dallohen figura të rëndësishme të kohës, sipas renditjes:

- Mytesim Këlliçi
- Aqif Elbasani
- Abdi Toptani
- Ahmet Zogu
- Eshref Frashëri
- Ismail Ndroqi (Kryetari i Bashkisë së Tiranës)

Këta burra shteti përfaqësonin vullnetin politik për konsolidimin e shtetit shqiptar dhe për mbrojtjen e integritetit territorial të vendit.

Nga kryeqytet i perkohshëm në kryeqytet përfundimtar

Çështja e vendosjes përfundimtare të kryeqytetit mbeti e hapur deri në vitin 1925, kur Asambleja

Kushtetuese, në kuadër të shpalljes së Republikës Shqiptare dhe miratimit të Statutit Themeltar (Kushtetutës republikane), e shpalli Tiranën përfundimisht kryeqytet të Shqipërisë.

Kështu, periudha e Pavarësisë (28 Nëntor 1912 – 7 Prill 1939) përfshin edhe këtë akt të rëndësishëm institucional, që shënoi konsolidimin e Tiranës si qendër e jetës politike dhe shtetërore shqiptare.

Transformimi i Tiranës në qendër politike dhe shoqërore

Deri në fillim të shekullit XX, Tirana kishte qenë një qytet me zhvillim të qëndrueshëm, për afro dy shekuj nën degën e familjes Toptani nga Kruja. Që nga mesi i shekullit XVII, qyteti ishte zgjeruar me ndërtimin e

pazarit dhe zhvillimin e zejeve të ndryshme. Lagjet e vjetra, si ajo e Mujos dhe e Pazarit, përbënin bërthamën historike të qytetit.

Pas vitit 1920, Tirana nisi një transformim të thellë urban dhe institucional. Dokumentet e kohës dëshmojnë për hartimin e planeve rregulluese, ndërtimin e godinave qeveritare dhe organizimin e infrastrukturës urbane që do t'i rezistonte kohës. Një pjesë e këtyre të dhënave janë përmbledhur në një album të hartuar nga Osman Myderizi, i ruajtur në regjistrat e seksioneve të Bashkisë së Tiranës, duke përbërë një burim të vyer për historinë urbane të kryeqytetit.

Me vendosjen e institucioneve shtetërore, Tirana u kthye në qendër të jetës politike, shoqërore dhe ushtarake të vendit. Këtu u përqendruan vendimarrja kombëtare, organizimi i administratës dhe strukturimi i forcave shtetërore që do të mbronin pavarësinë dhe rendin kushtetues.

Rëndësia për historinë kombëtare dhe për Forcat e Armatosura

11 Shkurti 1920 nuk është thjesht një datë kalendarike, por një pikë kthese në historinë e shtetit shqiptar. Vendosja e qeverisë në Tiranë simbolizoi ringritjen e autoritetit shtetëror dhe afirmimin e sovranitetit kombëtar përballë sfidave të brendshme dhe të jashtme.

Kjo datë ka një domethënie të veçantë, pasi lidhet drejtpërdrejt me konsolidimin e institucioneve shtetërore, përfshirë strukturat e para të organizimit të mbrojtjes kombëtare. Mbrojtja e qeverisë së Lushnjës dhe e rendit të ri shtetëror ishte një akt përgjegjësie kombëtare, ku populli dhe strukturat shtetërore u bënë një në mbrojtje të pavarësisë.

Jeta e Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë fillon më 11 shkurt 1920, një datë që shënon jo vetëm zhvendosjen e qendrës administrative, por lindjen e një etape të re në historinë e shtetit shqiptar. Nga ai moment, Tirana do të bëhej zemra politike e kombit dhe simbol i vazhdimësisë së shtetësisë shqiptare.



Kleriku Ismail Ndroqi Kryetari i Bashkisë së Tiranës në vitin 1920 ka dhënë një ndihmesë të vyer në përgatitjen e Kongresit të Lushnjës dhe për vendosjen në Tiranë të qeverisë së dalë prej tij.

Aktiviteti i inteligjencës ruse në Operacionin Ushtarak Special (OUS) në Ukrainë - Dështimi dhe sukcesi

NËNKOLONEL ERVIN HODO

Evolucioni i Inteligjencës Ushtarake Ruse në Operacionin Ushtarak Special: Nga Dështimi Strategjik drejt Operacionalizimit të Kompleksit Zbulim-Goditje (RUK)

Dokumenti Doktrinor i Ushtrisë Amerikane (Army Doctrine Publication-ADP) 3-0, "Operations", thekson se funksioni luftarak i Inteligjencës, përfshin detyrën për të "ofruar mbështetje të inteligjencës për procesin e targetimit dhe për kapacitetet informative". Mendimtarët ushtarakë rusë, e kanë kuptuar prej kohësh këtë parim bazë dhe kanë përfytyruar një sistem të sinkronizuar, të informuar nga inteligjenca, për të goditur në mënyrë vendimtare objektivat në të gjithë thellësinë e territorit të një kundërshtari. Përmes përshtatjeve që Rusia ka arritur të bëjë, Operacioni Ushtarak Special (OUS), ka qenë mjedisi në të cilin janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt realizimit të këtij vizioni.

Operacioni Ushtarak Special, i nisur në shkurt 2022, ekspozoi mangësi të theksuara në vlerësimin strategjik të inteligjencës ruse. Supozimi për një kolaps të shpejtë politik dhe ushtarak të Ukrainës rezultoi i pasaktë. Megjithatë, dinamika e konfliktit tregoi një proces adaptimi të konsiderueshëm në nivel operacional dhe taktik.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë:

- Shkaqet e dështimit fillestar të inteligjencës ruse.
- Rolin e HUMINT, SIGINT dhe UAV në transformimin operacional.
- Evolucionin praktik të kompleksit RUK.
- Implikimet doktrinale për luftën moderne.

Korniza Doktrinale: RUK në Mendimin Ushtarak Rus

Koncepti i **Razvedyvatel'no-Udarnyy Kompleks (RUK)** u zhvillua në doktrinën sovjetike gjatë viteve 1970-1980 si një sistem i integruar që lidhte:

- Zbulimin (razvedka)
- Komandën dhe kontrollin (C2)
- Mjetet e zjarrit (artileri, raketa operacionale-taktike, aviacion)

RUK synonte reduktimin e kohës midis zbulimit dhe goditjes, duke krijuar një cikël të shpejtë vendimmarrjeje dhe shkatërrimi të objektivave me vlerë të lartë.

Doktrina ushtarake ruse pas vitit 2014, si dhe dokumentet mbi "luftën e brezit të ri", theksojnë:

- Integrimin e inteligjencës me zjarret precize.
- Përdorimin e sistemeve të automatizuara të komandës.
- Dominimin e hapësirës informacionale.

OUS ofroi kontekstin praktik për testimin real të këtyre koncepteve.

Dështimi Strategjik i Inteligjencës

Paragjykimi Ideologjik dhe "Mirror Imaging"

Elitat politike dhe të sigurisë ruse operuan mbi premisa ideologjike që e perceptonin Ukrainën si një entitet shtetëror të brishtë. Ky perceptim prodhoi:

- Nënvlerësim të vullnetit të rezistencës.
- Mbivlerësim të potencialit për bashkëpunim lokal.
- Supozim për neutralitet ose mbështetje popullore në zonat lindore.

Strukturat Autoritare dhe Kultura "Zero-Defekte"

Në sistemet autoritare, raportimi i inteligjencës shpesh përshtatet me pritshmëritë e leadershipit. Kjo



krijon:

- Filtrim informacioni.
- Vetë-censurë analitike.
- Konfirmim të narrativave ekzistuese.

Rezultati ishte një dështim në nivelin strategjik, jo domosdoshmërisht mungesë aftësish teknike.

HUMINT: Korrupsioni dhe Kufizimet Strukturore

Problematika Operacionale

Raportime të shumta sugjerojnë:

- Rekrutime formale për përfitime financiare.
- Informatorë me motivim ekonomik, jo ideologjik.
- Verifikim i pamjaftueshëm i objektivave.

Pasojat përfshinë:

- Targetim të pasaktë.
- Goditje mbi objekte me vlerë të ulët operative.
- Mos përcaktim të manovrave ukrainase (p.sh., kundërofensiva në Kharkiv).

Adaptimi

Me kalimin e kohës, HUMINT u integrua më ngushtë me:

- ISR ajrore (UAV).
- SIGINT taktik.
- Vlerësim dëmsh në fushëbetejë (Battle Damage Assessment - BDA).

Kjo sinergji përmirësoi cilësinë e targetimit.



Korrupsioni sistemik dhe cilësia e dobët e inteligjencës ruse

Edhe pse agjentët rusë, arritën të rekrutonin informatorë në të gjithë Ukrainën, Rusia nuk kishte një pamje të qartë mbi qëndrimin e popullit ukrainas dhe vullnetin e tij për t'u rezistuar. Kjo, lidhet pjesërisht me korrupsionin midis rekrutuesve dhe drejtuesve të FSB dhe GRU. Praktika ruse e dhënies së fondeve për shpërblim, kërkonte që drejtuesi të raportonte rekrutimin e suksesshëm të një informatori dhe sa para i kishte dhënë agjenti informatorit. Pavarësisht raportimeve për rekrutimin e disa sabotuesve ukrainas të gatshëm, në shumë raste drejtuesi paraqiste një raport të rremë për rekrutimin dhe mbante paratë e shpërblimit. Në raste të tjera, cilësia e informatorëve mund të ketë qenë e dyshimtë nga perspektiva ruse; disa informatorë ndoshta nuk ishin mbështetës të vërtetë të Rusisë, por ishin "thjesht për paratë". Gjithashtu, ka pasur vështirësi për të rekrutuar mjaftueshëm informatorë, që të raportonin informacion saktë.

Kjo situatë, theksohet edhe nga kultura ruse e udhëheqjes "zero-defekte", ku ekziston presion i madh për të raportuar se gjithçka po shkon "sipas planit". Edhe nëse dikush ka dyshime mbi informacionin e inteligjencës, ose mbi aftësinë e burimeve për raportim të saktë, ekziston presion për të raportuar atë që shefi dëshiron të dëgjojë. Nëse shefi, dëshiron një pamje të Ukrainës që do të dorëzohet shpejt, ky është informacioni që i raportohet – pavarësisht nëse inteligjenca e mbështet apo jo. Këto shtresa të kulturës së udhëheqjes të korrumpuar, krijojnë një kapacitet HUMINT të dobët, që mbështetet në një rrjet informatorësh jo idealë ose madje të padeklaruar.

Nëse Rusia e kuptoi ose jo, se kishte një problem në operacionet HUMINT mbetet një pyetje e hapur. Raportimet nga burime të hapura mbi Drejtorin e Shërbimit të 5-të të FSB, Sergey Beseda, nënvizojnë këtë paqartësi. Beseda, raportohet të ketë qenë përgjegjës për inteligjencën mbi situatën politike në Ukrainë para fillimit të OUS. Disa raportime tregojnë se Beseda u akuzua për shpërdorim fondesh, të destinuara për operacione të fshehta në Ukrainë dhe për ofrimin e informacionit të pasaktë mbi ngjarjet politike atje. Sipas këtyre raportimeve, në fillim të prillit 2022, Beseda u vendos nën arrest shtëpie dhe më pas u transferua në paraburgim në Burgun Lefortovo.

Nga ana tjetër, raportimet javë dhe muaj më vonë tregonin shumë pak ose aspak shqetësim mbi dështimet në operacionet HUMINT, duke përshkruar shfaqje publike dhe jo-publike të Besedës. Ai, nuk u zëvendësua zyrtarisht si drejtor i Shërbimit të 5-të të FSB-së deri në qershor 2024, kur arriti moshën 70 vjeç. Kjo mungesë e dukshme e përgjegjësisë, për një operacion inteligjence të dështuar, mund të lidhet me një kombinim të mungesës së gatishmërisë për të pranuar gabimin dhe një sistemi të korrumpuar.

Targetimi i dobët si tregues i HUMINT-it të keq

Shumë raste të targetimit të gabuar, mund të shpjegohen, të paktën pjesërisht, nga HUMINT i dobët. Kjo bën që Forcat e Armatosura Ruse (FAR), të targetojnë bazuar në modele të gabuara dhe supozime të pasakta. Shpesh, këto supozime reflektojnë "imazhin e pasqyrës" – supozimi se armiku do të sillt si ju.

Një shembull tipik, është sulmi i hershëm i qershorit 2022 ndaj fabrikës së riparimit të vagonëve Darnitsky në Kiev me raketë "Cruise". Ministria Ruse e Mbrojtjes pretendoi se objekti ishte një depo për tanket T-72 të furnizuara nga Perëndimi. Videoja më vonë tregoi se nuk kishte as tanke, as pajisje të tjera ushtarake në fabrikën e shkatërruar. Forcat ruse, po targetonin me dëshpërim çdo depo hekurudhore për të ndaluar furnizimin e pajisjeve ushtarake perëndimore, që arrinin në Ukrainë. Për shkak të "imazhit të pasqyrës", rusët supozuan se forcat ukrainase do të transportonin pajisje ushtarake kryesisht me tren, siç do të bënin vetë forcat ruse. Kjo varësi nga modelimi dhe supozimet e gabuara evidenton cilësinë e dobët të mbledhjes së HUMINT rus.

Rasti i mundjes së Forcave të Armatosura Ruse, nga ana e Forcave të Armatosura të Ukrainës (UAF) të në zonën Izyum-Balaklia në 2022 ofron një shembull tjetër të HUMINT të dobët. Brigada 45-të e Gardës VDV

Spetsnaz e GRU, ishte caktuar për zbulim operacional në sektorin jugperëndim të Izyumit dhe humbi gjurmët e pesë brigadave ukrainase.

Një përjashtim i suksesshëm i HUMINT-it të FSB

Një shembull i rrallë i HUMINT-it rus të suksesshëm ndodhi në 2022. Në prill 2023, në rrjetet sociale ukrainase u shfaq një histori mbi një përpjekje të HUMINT-it ukrainas për të rekrutuar pilotë të Forcave Ajrore Ruse (VKS) për të dorëzuar avionë rusë në Ukrainë. Ukrainasit kishin të dhëna për pilotët për t'i shantazhuar dhe planifikuan dorëzimin e avionëve. FSB-ja ruse mësoi për operacionin, arrestoi pilotët dhe më pas u prezantuan si pilotë rusë të VKS-së. Në fund, FSB dhe FAFR sulmuan me sukses bazën ku avionët do të dorëzoheshin me raketa, duke shkaktuar viktima te forcat ushtarake ukrainase dhe shkatërrimin e avionëve ukrainas, përfshirë ndoshta një dron “Bayraktar”.

Shfrytëzimi maksimal i HUMINT të kufizuar përmes UAV

Më4nëntor2023,Forcat e Armatosura Ruse, vendosën një UAV mbi Zarichne, Oblasti (rajoni) Zaporizhia, 35 km në veri të Linjës së Kontaktit të Luftës, për të konfirmuar HUMINT-in e mëparshëm. Objektivi ishte një mbledhje e artiljerëve të Brigadës 128-të Malore të Ukrainës për një ceremoni shpërblimesh. Me shumë probabilitet përmes HUMINT-it (ndoshta një DRG), rusët morën informacion mbi ceremoninë dhe UAV-ja konfirmoi objektivin me saktësi të mjaftueshme. Rezultati ishte një sulm me raketë balistike Iskander-M, ose raketë të drejtuar Tornado-S. Ukraina, pësoi të paktën 28 të vrarë dhe 53 të plagosur, duke shkatërruar udhëheqjen e artilerisë së brigadës. Kjo tregon, se rusët kanë zhvilluar mënyra për të shfrytëzuar sistemet e UAV-ve për të bërë të dobishëm edhe një HUMINT të kufizuar.

Ndërkohë që aktiviteti i DRG-ve vazhdon, duket se aktiviteti i agjentëve HUMINT në nivel operacional është zvogëluar. Rusia ka kompensuar këtë diferencë duke zhvilluar taktika, teknika dhe procedura (TTP) për UAV-të.

Orlan-10 i forcave pushtuese të Federatës Ruse, i cili u neutralizua me mjete të luftës elektronike (EW), gusht 2022. (Forcat Ajrore Sulmuese të Ukrainës)

Transformimi i mbledhjes së inteligjencës nga UAV

Përpara OUS, Rusia përdorte UAV për mbledhje të inteligjencës imazherike (IMINT) dhe ndonjëherë për SIGIN, por rusët kishin synuar kryesisht HUMINT për inteligjencën operacionale. Rusia duhej të përballej me TTP efektive kundër UAV-ve ukrainase dhe përdorimin efektiv të UAV-ve për zbulim, mbikëqyrje dhe rikonicion (ISR). Me kohë, Rusia kuptoi dhe shfrytëzoi potencialin e plotë të UAV-ve, duke zhvilluar kapacitetet teknike dhe TTP të përshtatshme për mbledhje të efektshme dhe në kohë. Rezultati ishte një hap cilësor në aftësinë për të mbledhur inteligjencë të targetueshme dhe për ta transmetuar tek asetet e sulmit. Kjo aftësi, aplikohet kryesisht për UAV-të ushtarakë me krah të fiksuar dhe rreze prej rreth 30 km, ose më shumë.

Në distanca taktike më të afërta, dronët helikopterë nga të dyja palët kanë transformuar fushën e betejës në një mjedis pothuajse “të pamundur për t’u fshehur”. Disa analistë e quajnë këtë “demokratizim” të fushës së betejës, pasi të dyja palët, deri te njësitë më të vogla, mund të mbledhin inteligjencë të zbatueshme mbi pothuajse çdo detaj në fushëbetejë. Shumë nga këta UAV të vegjël janë “kamikazë”, që shërbejnë si për mbledhjen e IMINT ashtu edhe për të goditur objektivin e synuar.

Përdorimi fillestar i dobët i UAV-ve në fillim të OUS

Në fillim të OUS, rusët përdornin kryesisht UAV-të Orlan-10 për zbulim, duke u bazuar në përvojën e fituar nga përdorimi i tyre në Donbas dhe Siri. Në Siri, Forcat Ajrore Ruse (VKS) dhe ndoshta Forcat Tokësore fluturuan këto UAV që nga vjeshta e vitit 2015 në distanca operative.

Megjithatë, e njëjta praktikë nuk solli sukses fillimisht gjatë OUS. Forcat e Armatosura të Ukrainës (UAF) i rrëzuan këta UAV në numër të madh gjatë muajve të parë të OUS, duke përdorur metoda të ndryshme, përfshirë goditje kinetike dhe depërtim (hacking) në sistemet e kontrollit të UAV, duke i detyruar ato të kryenin ulje emergjente.

Shumica e këtyre Orlan-10 i përkisnin Forcave Ajore Ruse, por ka tregues se edhe agjenci të tjera ruse të inteligjencës, si SVR dhe FSB, i kanë përdorur Orlan-10-at.

UAV si Katalizator i Operacionalizimit të RUK

Faza Fillestare: Humbje dhe Fragmentim



Në muajt e parë, Rusia pësoi humbje të konsiderueshme të UAV-ve (p.sh., Orlan-10). Mungesa e koordinimit efektiv me artilerinë kufizoi potencialin e tyre.

Faza e Adaptimit

Nga mesi i vitit 2023 u vërejt:

- Konstelacione UAV (platforma në lartësi të ndryshme).
- Integrim me sisteme precize si “Iskander” dhe “Lancet”.
- Përdorim i sistemeve të automatizuara si Strelets-M (KRUS).
- Zhvillim i Orlan-30 me lazer për drejtim preciz.

Rezultati ishte:

- Reduktim i kohës sensor–shooter.
- Rritje e goditjeve ndaj objektivave të ndjeshëm ndaj kohës.
- Targetim në thellësi operative.

Ky zhvillim përfaqëson realizimin praktik të RUK në nivel taktik-operacional.

SIGINT, EW dhe Lufta Informacionale

Kapacitetet

Rusia disponon:

- Njësi SIGINT (OsNaz).
- Sisteme EW si Borisoglebsk-2.
- Platforma LEER-3 për ndërhyrje GSM.
- Aftësi kibernetike për infiltrime dhe malware.

Dobësitë

Megjithatë, interceptimet ukrainase treguan:

- Disiplinë të dobët komunikimi.
- Mungesë COMSEC në nivele taktike.
- Përdorim të telefonave civilë nga personeli.

Kjo krijoi një paradoks: aftësi të larta teknike, por disiplinë operative jo konsistente.

Krahasim me Multi-Domain Operations (MDO)

Koncepti amerikan i **Multi-Domain Operations (MDO)** synon integrimin e efekteve në:

- Tokë
- Ajër
- Det
- Hapësirë
- Hapësirë kibernetike

RUK mund të konsiderohet pararendës konceptual i MDO në aspektin e integritimit sensor–shooter, por ndryshon në:

- Theksin rus mbi artilerinë masive.
- Centralizimin më të madh të vendimmarrjes.
- Integrimin më të kufizuar ndër-domenësh krahasuar me modelin amerikan.

Megjithatë, OUS tregoi se Rusia po lëviz drejt një modeli më të integruar ndër-domenësh, veçanërisht përmes UAV dhe EW.

Inteligjenca ruse dështoi në vlerësimin strategjik fillestar për shkak të faktorëve politikë dhe kulturorë.

Anija e mbledhjes së SIGINT “Ivan Khurs”

Përmirësime në analizën e inteligjencës

Qasja tipike ruse, ndaj targetimit formulohet si: apliko formulën e duhur mbi objektivin e dëshiruar dhe sulmo objektivin me sasinë dhe llojin e municionit të nxjerrë nga formula dhe puna konsiderohet e kryer (në teori). Megjithatë, FAR po tregojnë shenja të targetimit më të saktë, çka tregon mbledhje më të mirë të informacionit dhe analizë më të qëllimshme të situatës. Forcat e Armatosura Ruse (FAR) mund të jenë motivuar të vendosin këto TTP për shkak të pranisë së objektivave me vlerë të lartë në fushëbetejë, si HIMARS dhe “Patriot”, nevojës për të menaxhuar më mirë rezervat e municionit dhe disponueshmërisë së UAV-ve që mund të mbledhin inteligjencë për t'u analizuar. Dy fusha, ku kjo duket se po ndodh janë mbledhja dhe analiza e vlerësimit të dëmeve në fushëbetejë (VDB) dhe informacionit të *pattern-of-life*. Ka shenja që mund të jetë duke përdorur OSINT, të mbledhur nga mediat sociale për të përmirësuar analizën e inteligjencës.

Mbledhja dhe analiza e OSINT nga mediat sociale

Edhe pse është e vështirë të përcaktohet me shembuj konkretë, duket e mundshme që agjencitë e inteligjencës ruse dhe FAR i kushtojnë vëmendje postimeve ukrainase në mediat sociale. Në të paktën një rast, një rrjet social ushtarak rus shfaqti fotografi të një njësie të veçantë të FAU me tanke Leopard 2A4, duke përfshirë detaje teknike për tankun dhe ushtarët specifikë të FAU. Nga kjo, është e arsyeshme të supozohet se GRU dhe agjenci të tjera të inteligjencës ruse kanë akses në këto imazhe. Në një situatë tjetër, Forcat Tokësore Ruse morën informacion VDB nga fotografi që shumë shpejt mund të ishin marrë nga mediat sociale ukrainase, brenda një zone objektivi pranë Barvinkove në Rajonin Kharkiv.

Integrimi i Inteligjencës dhe kompleksi zbulim/inteligjencë-sulm

Për të përshtatur fjalët e Enciklopedisë së Madhe Ruse, kompleksi Zbulim/Inteligjencë-Sulm (RUK) është mjet kolektiv i inteligjencës, komandës dhe kontrollit, dhe zjarrit të organizuar për të shkatërruar në mënyrë efektive (dhe të saktë) kapacitetin luftarak të armikut. Për dekada, studiuesit ushtarakë rusë kanë shkruar se si duhet të funksionojë RUK si një makineri e mirë-lubrifikuar dhe e sinkronizuar. Në fillim të SMO-së, FAR ishte shumë e ndarë për të koordinuar dhe sinkronizuar ISR, C2, dhe zjarret. Por adoptimi nga Rusia i teknologjisë UAS dhe TTP duket se ka katalizuar jo vetëm përmirësime të mëdha në sinkronizimin e inteligjencës dhe C2 me asetet sulmuese të FAR, por edhe me asetet sulmuese të VKS. Ka gjithashtu prova, që FAR po përdor sistemin “Strelets” për të ndihmuar në këtë transformim të gjatë ëndërruar.

HUMINT u dëmtua nga korrupsioni dhe vlerësime të pasakta.

Integrimi i UAV-ve përbën pikën e kthesës në efektivitetin operacional.

RUK po kalon nga koncept doktrinor në realitet praktik.

Lufta në Ukrainë ka përshpejtuar transformimin e inteligjencës ruse drejt një modeli më të integruar ISR–C2–Fire.

Burimi: “How Russia Fights”

Inteligjenca Artificiale dhe Kufijtë e Pavarësisë

Inteligjenca artificiale është një nga temat më komplekse dhe më të rëndësishme të kohës sonë, duke prekur çdo aspekt të jetës moderne dhe duke ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si ne punojmë, komunikojmë dhe ndërveprojmë me botën përreth nesh. Ajo shtrihet nga aplikacionet e thjeshta në telefonat tanë deri te sistemet komplekse që drejtojnë makina autonome apo sisteme të menaxhimit të të dhënave, duke fituar gjithnjë e më shumë pavarësi në funksionimin e saj. Megjithatë, kjo pavarësi nuk është absolute dhe ngre shumë pyetje të rëndësishme rreth kufijve që duhet të vendosen për të siguruar që teknologjia të përdoret në mënyrë etike dhe të përgjegjshme.

Rrjetet Sociale dhe Profilet e AI-së

Në botën e rrjeteve sociale, inteligjenca artificiale po merr një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Platforma të ndryshme po krijojnë profile të drejtuara nga AI-ja, të cilat kanë aftësinë të postojnë, komentojnë dhe të ndërveprojnë me përdoruesit në mënyrë që të duken sa më njerëzore. Këto profile, të njohura si “agjentë AI”, janë në gjendje të krijojnë përmbajtje origjinale, të japin këshilla dhe të marrin pjesë në diskutime publike, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit përfuturojnë dhe përdorin rrjetet sociale.

Ky fenomen ngre disa pyetje të rëndësishme që kërkojnë reflektim të thellë. Si mund të dallojë një përdorues nëse po komunikon me një njeri apo me një inteligjencë artificiale? A duhet të jetë e detyrueshme që këto profile të tregojnë qartë natyrën e tyre artificiale për të ruajtur transparencën dhe besueshmërinë? Për më tepër, çfarë ndikimi mund të ketë kjo në formësimin e opinionit publik dhe në proceset demokratike, duke marrë parasysh se përmbajtja e krijuar nga AI mund të manipulojë mendimet dhe ndjenjat e njerëzve?

Kufijtë e Pavarësisë së AI-së

Pavarësia e inteligjencës artificiale është një koncept relativ dhe i kufizuar nga faktorë të ndryshëm. Në thelb, çdo sistem AI është i varur nga infrastruktura teknologjike, programuesit që e krijojnë dhe rregullojnë atë, si dhe nga të dhënat që përdor për të mësuar dhe përmirësuar performancën e tij.

Serverët dhe energjia janë baza fizike që mbështesin funksionimin e AI-së. Pa këto, asnjë sistem nuk mund të operojë. Programuesit vendosin rregullat dhe kufizimet që përcaktojnë mënyrën se si AI-ja mund të veprojë, duke siguruar që ajo të mos kalojë kufijtë e caktuar. Gjithashtu, të dhënat janë thelbësore për mësimin e AI-së; pa informacion të saktë dhe të mjaftueshëm, AI-ja nuk mund të zhvillohet apo të marrë vendime të informuara.

Megjithatë, me avancimin e teknologjisë, ekziston rreziku që sistemet e avancuara të marrin vendime pa mbikëqyrje të plotë njerëzore. Kjo ngre dilema të mëdha etike dhe ligjore, sidomos në fusha kritike si mjekësia, drejtësia dhe siguria kombëtare. A duhet të lejojmë që AI-ja të ketë autonomi të plotë në këto fusha, apo duhet të vendosen mekanizma të fortë kontrolli dhe përgjegjësie?

Rreziqet e Pavarësisë së AI-së

Pavarësia e AI-së sjell me vete disa rreziqe të rëndësishme që duhet të merren seriozisht parasysh. Një nga këto është manipulimi i informacionit, ku një AI e pavarur mund të krijojë dhe shpërndajë përmbajtje të rreme në mënyrë masive, duke ndikuar negativisht në perceptimet dhe vendimet e njerëzve.

Gjithashtu, vendimet e marra nga AI pa mbikëqyrje mund të jenë të rrezikshme dhe të shkaktojnë pasoja të paparashikuara, sidomos në situata ku vendimet kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve. Një tjetër shqetësim është mungesa e përgjegjësisë, pasi është e paqartë se kush duhet të mbajë përgjegjësi për veprimet e një AI që vepron në mënyrë autonome.

Shembuj Praktikë

Në praktikë, ka disa shembuj ku AI ka një nivel të caktuar pavarësie, por gjithmonë brenda kufijve të përcaktuar nga njerëzit. Makinat autonome janë një shembull i qartë, ku vendimet merren në kohë reale pa ndërhyrje njerëzore, por gjithmonë duke respektuar rregullat dhe parametrat e programuar.

Në fushën ushtarake, disa vende po zhvillojnë dhe testojnë dronë autonome, një zhvillim që ngre shqetësime të mëdha për etikën e përdorimit të

teknologjisë në luftë. Në mjekësi, AI-ja përdoret për të ndihmuar në diagnoza dhe trajtime, por vendimi final mbetet gjithmonë në dorën e mjekut, duke siguruar një kontroll njerëzor mbi proceset kritike.

Etika dhe Ligji

Për të siguruar që pavarësia e AI-së të mos çojë në pasoja negative, është e domosdoshme të vendosen rregulla dhe ligje të qarta. Këto duhet të përfshijnë transparencën në mënyrën se si AI-ja funksionon, përgjegjësinë për veprimet e saj dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme nga ana e njerëzve.

Vetëm me këto masa mund të krijojmë një ekuilibër të shëndetshëm mes inovacionit teknologjik dhe etikës, duke garantuar që AI-ja të përdoret në mënyrë të sigurt dhe të dobishme për shoqërinë.

Inteligjenca artificiale është një mjet i fuqishëm dhe me potencial të jashtëzakonshëm për të transformuar shoqërinë në shumë aspekte. Megjithatë, pavarësia e saj duhet të trajtohet me kujdes dhe përgjegjësi, duke vendosur kufij të qartë që mbrojnë vlerat njerëzore dhe sigurinë kolektive. Rrjetet sociale me profile AI janë vetëm fillimi i një epoke të re, ku sfida kryesore do të jetë të gjejmë balancën e duhur mes inovacionit dhe etikës, për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë.



Armët robotike dhe sistemet e avancuara të luftës tashmë kanë filluar të dominojnë tokën dhe detin, ndërsa edhe hapësira ajrore po ecën me ritme të shpejta drejt automatizimit. Lufta detare po përjeton një transformim të thellë: epoka e flotave të mëdha me ekuipazh po zbehet, duke ia lënë vendin një qasjeje të re ku anijet sipërfaqësore pa pilot (USV) po marrin rolin kryesor.

Këto mjete të vogla, të lira dhe shumë më të zgjerueshme se anijet tradicionale, po bëhen elementë të pazëvendësueshëm në misionet më të rrezikshme dhe më të ndërlikuara. Ato nuk janë thjesht platforma të automatizuara – janë sisteme të afta të mbajnë sensorë, armë dhe pajisje komunikimi që dikur kërkonin ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të njeriut.

Falë tyre, po lindin koncepte të reja taktike si operacionet e shpërndara detare, ku rrjete të tëra USV-sh përhapin aftësitë e zbulimit, sulmit dhe mbrojtjes në sipërfaqe të gjera oqeanike. Kjo qasje e decentralizuar e bën shumë më të vështirë për çdo kundërshtar të parashikojë, të kontrollojë ose të neutralizojë veprimet e flotës. Më poshtë paraqiten shtatë USV inovative.



“Sea Hunter” (Shtetet e Bashkuara)

“Sea Hunter” është një pikë referimi për mënyrën se si autonomia po sjell një valë ndryshimesh në operacionet detare. Ky trimaran 132 këmbësh u ndërtua për të ndjekur nëndetëset për periudha të gjata pa ekuipazh në bord.

Me qëndrueshmërinë si forcën e tij më të madhe, “Sea Hunter” mund të udhëtojë më shumë se një mijë milje detare dhe të qëndrojë në det për muaj të tërë. Një qershi mbi tortë është se operon me një kosto shumë më të ulët se një shkatërrues ditor, duke e bërë atë ideal për patrulla të vazhdueshme anti-nëndetëse dhe kundërmasa kundër minave që përndryshe do të bllokoni anijet e vlefshme me ekuipazh.



“Seahawk” (Shtetet e Bashkuara)

Një version i evoluar i USV-së që pamë më parë, “Seahawk” u ndërtua nga “Leidos” bazuar në mësimet e nxjerra nga testimet e hershme. Trimarani i përbërë përmban shumë përmirësime që rrisin rrezën e veprimit, qëndrueshmërinë në det dhe kapacitetin e ngarkesës.

Këto përmirësime nënkuptojnë se “Seahawk” mund të mbajë më shumë sensorë, pajisje komunikimi dhe paketa misioni, duke e bërë atë më fleksibël në operacione reale. SHBA-të parashikojnë anije si “Seahawk” që udhëheqin operacione të mëdha përpara flotave të mëdha si zbulues, karrem dhe nyje mbikëqyrjeje të avancuara. “Seahawk” mund të zbulojë kërcënimet, të transmetojë të dhënat e synimit dhe të largojë vëmendjen e armikut nga anijet më të vlefshme.

Epoka e re e luftës detare: 7 anije sipërfaqësore pa pilot që po ndryshojnë lojën

“Magura” V (Ukrainë)

Familja “Magura” e Ukrainës qëndron si një dëshmi e asaj që mund të bëjnë avionët luftarakë amerikanë kur janë në veprim. Këta dronë detarë të mbushur me eksplozivë kanë shkaktuar dëme në anijet ruse në mënyrë të përsëritur në Detin e Zi. Ata demonstruan se një anije e vogël dhe me kosto relativisht të ulët mund të kërcënojë anije luftarake shumë më të mëdha.

Një anije tipike “Magura” e tipit V është me rreze të gjatë veprimi, e shpejtë dhe e aftë të mbajë një kokë luftarake të konsiderueshme. Të përdorura në kombinim me dronë ajrorë, këto avionë luftarakë amerikanë mund të shkatërrojnë mbrojtjet dhe të godasin objektivat në port ose në det, duke e shndërruar vijën bregdetare në një mjedis shumë më të rrezikshëm për forcat detare konvencionale. Me kalimin e kohës, variantet e “Magurës” kanë evoluuar përtej mjeteve të thjeshta sulmuese me një drejtim. Raportet sugjerojnë se versionet më të reja mund të mbajnë mitralozë, raketa antitank dhe madje edhe raketa ajër-ajër, duke e zbehur vijën ndarëse midis dronit kamikaz dhe platformës modulare shumërolëshe luftarake.



“Devil Ray T24” (SHBA – MARTAC)

Me një gjatësi prej 24 metrash, “Devil Ray T24” është projektuar për të kryer misione të shumfishta. Mund të kalojë 50-60 nyje dhe të mbajë një përzierje të madhe sensorësh dhe ngarkesash, duke ruajtur stabilitetin në kushte të vështira.

T24 mund të veprojë gjithashtu si “anija mëmë”, duke mbikëqyrur vendosjen e USV-ve ose UAV-ve më të vegjël, gjë që zgjeron shtrirjen dhe fleksibilitetin e flotave pa pilot. Duke filluar nga intelijenca dhe mbikëqyrja deri te kundërmasat ndaj minave dhe lufta elektronike, kjo USV mund të shërbejë në një gamë të gjerë rastesh përdorimi. Një kombinim i shkëlqyer i shpejtësisë, ngarkesës dhe dizajnit modular e bën “Devil Ray” të adaptueshëm për role të ndryshme, duke e bërë atë një makinë të dobishme për marinat që eksperimentojnë me



“Matangi” (Indi - Inxhinieri e Mbrojtjes Sagar)

E zhvilluar nga “Sagar Defence Engineering”, “Matangi” përfaqëson qëllimet e Indisë për të arritur autonomi detare vendase. Ajo ka demonstruar aftësi të besueshme për të operuar në mënyrë autonome në distanca të gjata pas përfundimit të udhëtimeve të gjata bregdetare nën sistemet e veta të navigimit dhe shmangies së përplasjeve.

India e parashikon rolin e “Matangi”-t përtej provave të thjeshta të navigimit. Me një mitraloz të rëndë me telekomandë, radar dhe aftësinë për të pritur dhe lëshuar dronë, USV po lëviz drejt shndërrimit në një aset të armatosur dhe të rrjetëzuar për mbrojtjen dhe



sigurinë bregdetare.

Variant-i 7 (Macja e Kuqe/ Operacionet Blu)

Një USV shumërolëshe 7 metrash i projektuar, Varianti 7 mund të operojë në ujëra bregdetare të kontestuara. I zhvilluar nga “Red Cat” dhe “Blue Ops”, është projektuar të jetë i vështirë për t’u zbuluar dhe i aftë të veprojë si një nyje mbikëqyrjeje dhe si një platformë sulmi.

Variant-i 7 pritet të funksionojë si pjesë e një rrjeti më të madh pa pilot, duke ndarë të dhëna me dronë dhe anije të tjera ndërsa merr informacion mbi synimin nga lart. Në varësi të konfigurimit të tij, ai mund të mbajë ngarkesa shpërthyes, raketa, armë automatike ose edhe të lëshojë UAV.

Ky fleksibilitet i lejon Variant-it 7 të ndryshojë rolet shpejt, nga droni sulmues në stilin kamikaz në anije patrullimi ose platformë qitjeje në distancë. Duke vepruar kështu, ai pasqyron një trend më të gjerë drejt anijeve modulare pa pilot që mund të rikonfigurohen ndërsa ndryshojnë misionet.



SELKIE 7 (Robotika e Makinerive Detare)

Ndryshe nga shumë anije të tjera në këtë listë, SELKIE 7 përqendrohet më shumë në ndjesinë dhe praninë sesa në luftimin e drejtpërdrejtë. Ndërtuar nga “Sea Machines Robotics”, ajo përdor softuer të përparuar autonomie për të kryer patrullime, studime dhe inspektime me kontroll minimal njerëzor.

SELKIE 7 mbështet studimin hidrografik, inspektimin e aseteve në det të hapur dhe misionet e sigurisë detare. Me hapësirë të integruar ngarkese dhe aftësinë për të vendosur dronë ajrorë ose ngarkesa të tjera, ajo shërben si një anije pune fleksibile dhe autonome si për aplikime civile ashtu edhe për siguri. Të marra së bashku, këto shtatë USV tregojnë se si sistemet pa pilot po kalojnë nga eksperimentet në elementët kryesorë të fuqisë detare. Ato po transformojnë misionet e mbikëqyrjes, goditjeve dhe rrezikut të lartë në një shkallë dhe kosto që anijet me ekuipazh vetëm nuk mund ta përballojnë.

Me marinat që vazhdojnë të shpërndajnë operacionet detare, sipërfaqja e oqeanit ka të ngjarë të mbushet me rrjete anijesh inteligjente pa pilot që punojnë së bashku me anijet tradicionale luftarake. Ky rrjet në rritje i makinave do ta bëjë fushën e betejës detare më të mbushur, më komplekse dhe shumë më të vështirë për t’u kontrolluar nga çdo kundërshtar.



ATDHEUka EMËR

